

Nr. 100/6 prot.

Korçë, më 24.02.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "Riparim- shërbimi i automjeteve" –Marrëveshje Kuadër.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50110000-9  
Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve të lidhura.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 6.016.650 (gjashtëmilonegjashtëmbëdhjetëmijëegjashtëqindpesë  
dhjetë) lekë pa TVSH.

**Shumatorja e çmimeve për njësi është :** 2.738.855

(dymilioneshtatëqindetridhjetëetëmijëetëqindpesëdhjetëpesë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 120.333 (njëqindnjëzetmijëetëqindetridhjetëtre) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1.

d. Formulari Lista e Çmimeve të Shërbimeve, sipas Shtojcës 2.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

K. Dishnica



A. Minerali



E. Filip



## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 2 406 660 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimeve në nenin 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*


Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

K. Dishnica



A. Minerali



E. Filip



## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1 203 330 lekë pa TVSH .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, për këtë arsye është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të Rregullave të PP ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

" Për kontratat e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ( 20% x 6.016.650 leke= 1.203.330 leke) . Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

A. Minerali



2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për veprimtaritë "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin :

1. VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
2. VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
3. VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

*(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe :

Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar;

" Neni 8 Detyrimet e pronarit ose të përdoruesit të mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove

1. Pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove, **për mirëmbajtjen dhe riparimin e këtyre mjeteve**, u drejtohen **vetëm** subjekteve të regjistruara në regjistër, sipas llojit të përcaktuar në M1 autorizimin përkatës.

2. Përfshihen nga detyrimi i pikës 1 të këtij neni pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove për veprimtaritë e shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse. ”

VKM nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar;

Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 1546, datë 29.3.2016 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

A. Minerali



Kriteri dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Kodi VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove kërkohet sepse këto shërbime , sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 106/2018 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9573, kryhen nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar , të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e kësaj veprimtarie, si dhe bazuar në shërbimet objekt kontrate për arsye se kërkohej shërbimet e riparimit e ndërrimit të pjesëve xhenerike dhe atyre motorike.

Kodi VII.3.B.1c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove , sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 106/2018 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9573, kryhen nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar , të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e kësaj veprimtarie, si dhe bazuar në shërbimet objekt kontrate për arsye se kërkohej shërbime për diagnostifikim , riparim ndërrim të pjesëve elektrike.

Kodi VII.3.B.1 / ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 106/2018 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9573, kryhen nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar , të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e kësaj veprimtarie, si dhe bazuar në shërbimet objekt kontrate për arsye se kërkohej shërbime për riparimin balancimin ndërrimin e gomave të automjeteve.

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje për ndikimin në mjedis, të tipit B, për "Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave ", lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).


*(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe në:

Ligjin Nr. 9573, datë 3.7.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar;

" Neni 4, pika 1:

A. Minerali



*Ushtrimi i veprimtarisë së autoriparimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u lejohet vetëm subjekteve, që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji. ”;*

VKM nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar;

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë lejen që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Kriteri dhe kategoritë e tij është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës.

Kërkesa për Leje mjedisi të tipit B, për "Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë" përcaktohet në përputhje me Shtojcën 1 "Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi", pika 10.4 , të Ligjit Nr. 52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.

Leja e miratuar nga agjencia rajonale e mjedisit dhe e lëshuar nga QKB-ja, i jep të drejtën e funksionimit, oe , sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 10448 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar dhe përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate) ”*

#### 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ( Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

A. Minerali



- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi 2.4** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për vete natyrën e veçantë të shërbimeve të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te cilesise ISO 9001 (e vlefshme)

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te mjedisit ISO 14001 (e vlefshme)

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te shëndetit dhe sigurimit në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:
  - a. Një inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti që është përgjegjësi teknik.
6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
  - a. 1 një specialist xhenerik
  - b. 1 një specialist motorist
  - c. 1 një specialist elektroaut
  - d. 1 një specialist gomist

A. Minerali



**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

- Për Përgjegjësin teknik duhet të paraqesin Diplomën apo "Dëshmi aftësie profesionale", të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas përcaktimit të nenit 9, pika 2 të Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar.
- Për personelin teknik të kualifikuar (katër specialistët e kërkuar), operatori ekonomik duhet të paraqesë , dëshmitë e kualifikimit .

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit. Ky është kusht ligjor sipas Nenit 6 "Kushtet dhe procedurat për regjistrim", pika 2 , të Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 të ndryshuar.

- Një specialist motorist me qëllim evidencimin dhe riparimin e pjesëve motorike.
- Një specialist xhenerik me qëllim evidencimin dhe riparimin e pjesëve xhenerike.
- Një specialist elektroaut, me qëllim diagnostifikimin dhe riparimin e difekteve elektrike, elektronike, sensoreve, sistemit të injeksionit të ushqimit në motor etj.
- Një specialist gomist me qëllim riparimin balancimin dhe ndërimin e gomave.

A. Minerali



*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 6 persona**.

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

*Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore : Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, për punësimin e mesatarisht 6 personave”*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

1 drejtues ligjor + 1 përgjegjës teknik + 4 specialistë= 6 persona.

Analiza jepet në pikën 6 më sipër .

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha Nëntor 2022 – Dhjetor 2022- Janar 2023, në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

A. Minerali

*(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).*

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, servis i cili duhet të ketë :

- Repart xhenerik
- Repart motorik
- Repart elektroaut
- Repart llamarine e bojatisjeje

dhe duhet të disponojë pajisjet dhe instrumentet e mëposhtme:

- a) Gropë riparimi , ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion , ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
- b) Elektrokompresor;
- c) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;
- ç) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergencës së gomave;
- d) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
- dh) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave;
- e) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;
- f) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave;
- g) Kompjuter për diagnostikimin e mjeteve ;
- gj) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit;
- h) Vegla matëse dhe të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik etj.;

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK,

**përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

*-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë të tijën se ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, që disponon pajisjet dhe instrumentet si më sipër (duhet të jepet adresa e saktë e servisit).*

**Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar nga OE**

A. Minerali

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pajisjet dhe instrumentet e servisit janë vendosur në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 1546, datë 29.3.2016 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" si dhe me shërbimet e kërkuara në kontratën që prokurohet.

*(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet janë sipas tabelave bashkangjitur, gjithsej 34 faqe.

### **Shërbimet që kërkohen:**

Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Shoqërisë Rajonale UK Korçë Sh.A– Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Shërbimet dhe riparimet do të kryhen sipas nevojës dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

A. Minerali

Subjekti fitues, shërbimin e autoriparimit duhet ta kryejë , në përputhje me Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar si dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij, dhe mban përgjegjësi për operacionet e kryera, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Shërbimi do të kryhet, me kohëzgjatje 12 muaj, periodikisht .

Vendi i ekzekutimit: tek servisi i operatorit ekonomik fitues të kontraktuar.

Afati maksimal i kryerjes së një shërbimi apo riparimi duhet të jetë jo më shumë se 4 ditë nga momenti i paraqitjes në servis, duke përjashtuar rastet e shërbimeve që kërkojnë më shumë kohë për t'u realizuar dhe që do të bëhen me negocim.

Operatori Ekonomik duhet të marrë përsipër shërbimin dhe riparimin për të gjithë listën e mjeteve që disponon UKRK SH.A.

Në rast të përsëritjes së një defekti apo defekteve të reja që mund të kenë rrjedhur si pasojë e këtij defekti të kryer me mangësi, riparimet do të bëhen nga Operatori Ekonomik, pa pagesë.

#### **Regjistri i mjeteve në riparim**

1. Operatori ekonomik fitues për shërbimin e autoriparimit që do të kryejë , duhet të mbajë një regjistrë, ku të shënojnë në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korrigjime:

- a) targën dhe numrin e shasisë së mjetit, ku do të bëhen ndërhyrjet;
  - b) të dhënat për ndërhyrjet e realizuara;
  - c) datën e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit pronarit të ligjshëm ose personit të autorizuar prej tij;
  - ç) gjenealitetet e personit, që dorëzon mjetin dhe të personit, të cilit i dorëzohet mjete.
- Mbajtja e këtyre të dhënave bëhet në çastin e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit.

Çdo ndërhyrje në riparimin e automjeteve do të shoqërohet me garanci.

#### **Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**

Servisi i Operatorit Ekonomik me të cilin do të lidhet kontrata në kuadër të Marrveshjes Kuadër.

Theksojmë se AK nuk paguan kosto shtesë transporti, për kryerjen e shërbimeve të kontratës, si për kryerjen e shërbimeve bazike si ndërim filtra, ndërim vaji, ndërim ferota , diagnostifikim difektesh etj , ashtu edhe për riparim shërbimet e tjera., pavarësisht vendndodhjes së servisit, por këto kosto të mundshme, të varura nga vendndodhja e servisit janë detyrim i operatorit ekonomik.

Adrian Minerali